

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

Procedura e Provave në Rastet Civile në Kosovë

Edicioni 2

Tetor, 2011

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

PASQYRA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. HYRJE	4
2. KORNIZA LIGJORE	4
A) Standardet Ndërkombëtare dhe Rajonale për të Drejtat e Njeriut	4
(1) Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)	4
(2) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF)	6
(3) Rekomandimet e Këshillit të Evropës	7
B) Ligji Vendor	8
(1) Dispozitat e Përgjithshme	8
(2) Dëgjimi i dëshmitarëve	9
(3) Dëshmitë materiale dhe shkresat	10
(4) Dëshmitë e ekspertëve	10
(5) Pushteti për të vendosur sanksione ndaj dëshmitarëve apo ekspertëve jo- bashkëpunues	12
3. PROCEDURA E PROVAVE NË RASTET CIVILE NË KOSOVË	12
A) Dëgjimi i deklaratave të dëshmitarëve	12
B) Provat në formë të shkresave	14
C) Procedura lidhur me provat në formë të mendimit të ekspertit	15
4. PËRFUNDIM	18
5. REKOMANDIME	19

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport nënvizon shkelje serioze gjatë zhvillimit të procedurës së provave në rastet civile pranë gjykatave në Kosovë. Raporti përqendrohet në tri fusha procedurale ku janë vërejtur shkelje: dëgjimi i dëshmitarëve gjatë dhënies së deklaratave verbale, nxjerrja e shkresave si dëshmi si dhe menaxhimi i provave të ekspertëve si verbale ashtu edhe me shkrim. Në raport është e përfshirë një analizë e detajuar e gjashtë shembujve të rasteve; secili prej tyre ilustron nga një tipar të ndryshëm të shkeljeve të vërejtura nga OSBE në këto tri fusha procedurale.

Raporti përfundon se përderisa korniza ligjore që rregullon procedurën e provave në rastet civile – në pjesën më të madhe të saj- është në pajtueshmëri me standardet për gjykim të drejtë, zbatimi i saj nga gjykatat thënë më së miri ka qenë e pabarabartë. Raporti përfundon se në shumë raste mangësitë në procedurën e provave janë mjaft serioze sa që nuk mund të thuhet se palët kanë pasur gjykim të drejtë.

Raporti jep një numër rekomandimesh, siç është Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) që të merr parasysh ofrimin e trajnimeve për gjyqtarë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën në cilësi të dëshmitarit, palëve që deklarohen si dëshmitarë, marrjen e provave në formë të shkresave dhe procedurën e provave të ekspertit. Po që se implementohen këto rekomandime, do të ndihmojnë që zhvillimin e procedurës së provave në rastet civile ta sjellin në pajtim me kushtet si të ligjit vendor ashtu edhe të standardeve ndërkombëtare dhe jurisprudencës për të drejtat e njeriut.

1. HYRJE

Procedura e provave është një nga gurë-themelet e procesit gjyqësor. Pa dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese në një rast, gjyqtari nuk do të jetë në gjendje të bëjë gjetjen e fakteve që duhet të mbështesin një aktgjykim të arsyetuar qartë dhe më kujdes. Ky është çelësi për të siguruar se e drejta për gjykim të drejtë të mos komprometohet. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, (OSBE) është e brengosur se mangësitë serioze në mënyrën se si zhvillohet procedura e provave në rastet civile pranë gjykatave në Kosovë shkelin si ligjin vendor ashtu edhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ky raport shtjellon si standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ashtu edhe kornizën ligjore të vendit që ka të bëjë me zhvillimin e procedurës së provave në rastet civile. Më pas, në kuptim të pajtueshmërisë së tyre me ato standarde analizon gjashtë shembuj nga rastet e monitoruara nga OSBE. Rastet që janë analizuar përqendrohen në tri fusha të procedurës së provave ku mangësitë e vërejtura ishin veçanërisht akute. E para nga këto ka të bëjë me procedurën e dëgjimit të dëshmitarëve, përfshirë rastet speciale që përfshijnë dëshmitarë fëmijë apo palë në procedurë që dëshmojnë në cilësi të dëshmitarit. E dyta ka të bëjë me nxjerrjen e shkresave si prova . E treta ka të bëjë me procedurën e provave të ekspertit. Raporti përfundon me disa rekomandime për Kuvendin e Kosovës, gjykatat dhe IGJK-në. Në veçanti raporti rekomandon ndryshimin e ligjit në atë mënyrë që të rregullojë më për së afërmi procedurën e provave të ekspertit dhe që të mundësojë të drejtën që palët të mund të dëgjohen si dëshmitarë; për më shumë, raporti rekomandon që IGJK të merr parasysh t'i trajnojë gjyqtarët civil lidhur me këto dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me procedurën e provave civile.

2. KORNIZA LIGJORE

A) Standardet Ndërkombëtare dhe Rajonale për të Drejtat e Njeriut

(1) Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

Neni 6(1) i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ) parasheh se, në përcaktimin e të “drejtave dhe obligimeve civile të tij apo të saj, çdokush ka të drejtën për dëgjim të drejtë dhe publik brenda kohës së arsyeshme nga gjykata apo tribunali i pavarur i themeluar me ligj.” Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), gjatë interpretimit të kësaj dispozite, ka gjetur se, përderisa Neni 6 garanton të drejtën për gjykim të drejtë, ai nuk rregullon çështjet siç janë pranueshmëria apo vlera provuese e dëshmive, duke i shikuar këto çështje si të atilla që më së miri rregullohen me ligj vendor.¹ GjEDNJ po ashtu ka përcaktuar se është në barrë të gjykatave vendore “të vlerësojë provat pranë saj si dhe atë se sa janë relevante dëshmitë” të cilat palët kërkojnë të administrohen. GjEDNJ gjeti se:

¹ *Shih Schenk kundër Zvicrës*, Aktgjykim i GjEDNJ-së i 12 korrikut 1988, para. 46 dhe *X. kundër Belgjikës*, Vendimi i Komisionit të GjEDNJ-së i 16 tetorit 1980, fq. 235.

“Gjykata megjithatë, duhet të përcaktojë [...] se a ka qenë procedura në përgjithësi, përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë dëshmitë, e drejtë siç kërkohet me Nenin 6[1].”²

Si rregull, GjEDNJ nuk do të rishqyrtojë vlerësimin e provave të bërë nga gjykata vendore. Megjithatë, kur mund të tregohet se gjykata vendore, nga dëshmitë ka nxjerrë “përfundime arbitrare apo tejet të padrejta”, baza për ri-vlerësim mund të ekzistojë.³ Ngjashëm, Neni 6 nuk i jep palëve ndërgjyqëse “të drejtë të pakufizuar për të siguruar praninë e dëshmitarëve pranë gjykatës”, duke nënvizuar se “normalisht është në anë të gjykatave kombëtare të vendosin se a është e domosdoshme apo e këshillueshme që të ftohet dëshmitari.”⁴ Sa i përket dëshmitarëve ekspertë, GjEDNJ ka dhënë vërejtjen se si rregull i përgjithshëm është në anë të gjykatave vendore të vlerësojnë dëshmitë pranë tyre, përfshirë mjetet për konstatimin e fakteve relevante [...].”⁵

Gjykimi i drejtë sipas Nenit 6(1) kërkon barazi të armëve; ky parim, siç është sqaruar nga GjEDNJ, kërkon që “secilës palë t’i jepet mundësi e arsyeshme që ta paraqes rastin e vet nën kushte që nuk e vendosin atë në situatë dukshëm të pafavorshme *vis-à-vis* kundërshtarit të vet”⁶ E drejta për “procedurë bazuar në parim të kundërshtimit” është një pjesë përbërëse e parimit të barazisë së armëve. GjEDNJ ka gjetur se kjo e drejtë:

“në parim nënkupton mundësinë e palëve në gjykim penal apo civil të kenë njohuri lidhur me, dhe të komentojnë në të gjitha provat e nxjerra apo vërejtjet e parashtruara, [...] me këndvështrim për të ndikuar në vendim të gjykatës [...].”⁷

E drejta për procedurë bazuar në parim të kundërshtimit po ashtu “do të thotë që dëgjimi i dëshmitarëve në përgjithësi të ketë mundësi kundërshtimi” dhe se “të gjitha dëshmitë, në parim, duhet të nxjerrën në prani të [palëve] në dëgjim publik me këndvështrim nga argumenti kundërshtues.”⁸

² *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 6 dhjetorit 1988, para 68. Shih po ashtu *Wierzbicki kundër Polonisë*, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 18 qershorit 2002, para. 45.

³ *Waldberg kundër Turqisë Nr 22909/93*, Vendimi i Komisionit të GjEDNJ-së i 6 shtatorit 1995, para. 2. Shih po ashtu *Camilleri kundër Maltës Nr 51760/99*, Vendimi i GjEDNJ-së i 16 marsit 2000.

⁴ *Accardi kundër Italisë Nr 30598/02*, Vendimi i GjEDNJ-së i 2- janarit 2005, para. 1.

⁵ *Sommerfeld kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 8 korrikut 2003. Në këtë rast, GjEDNJ, në para. 71, gjeti se, në një rast që përfshin qasjen në fëmijë për prindin jo-kujdestar, “[d]o të shkohej shumë larg të thuhet se nga gjykatat vendore gjithmonë kërkohet përfshirja e ekspertit të psikologjisë në çështje [...], por kjo varet nga rrethanat e veçanta të secilit rast duke pasur parasysh kujdesin e duhur në lidhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës së përfshirë.” Megjithatë, në një rast tjetër që përfshinte qasjen në fëmijë për prindin jo-kujdestar, GjEDNJ gjeti se dështimi i gjykatës vendore që të kërkojë raport të ekspertit të psikologjisë, shkeli të drejtat e prindit: GjEDNJ nënvizoi se Zyra Rinore që ishte e përfshirë në rast rekomandoi marrjen e mendimit të ekspertit: *Elsholz kundër Gjermanisë*, 2000-VIII; Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 13 korrikut 2000, paragrafët 52-52.

⁶ *Walston (Nr. 1) kundër Norvegjisë*, Aktgjykimi i GjEDNJ-së, i 3 qershorit 2003, para. 56.

⁷ *Vermeulen kundër Belgjikës* Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 22 janarit 1996, para. 33.

⁸ *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, fusnota e sipërme 4, para. 78. Shih po ashtu *Walston (Nr. 1) kundër Norvegjisë*, fusnota e sipërme 8, para. 58, ku GjEDNJ gjeti se nuk ka pasur nevojë të përcaktojë se a i kishte shkaktuar dështimi për të komunikuar provat paragykim paditësve: “ekzistimi i shkeljes është i mundshëm edhe në mungesë të paragykimit [...]. Është në anë të paditësve të gjykojnë se a kërkon apo jo një dokument komentet e tyre. [...] Në këtë rast, vet

GjEDNJ ka vendosur mbi shumë lloje të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjen e provave në kontekst të së drejtës bazuar në parim të kundërshtimit. Kur deklaratat e dëshmitarëve dhe shkresat thjeshtë janë lexuar për procesverbal, pa ju dhënë palëve mundësia për t'i komentuar ato, GjEDNJ ka gjetur se është shkelur e drejta për procedurë bazuar në parim të kundërshtimit.⁹ Kur, në një padi kundër një spitali, të ngritur për shkak të vdekjes së bijës së tyre, paditësve i u ishte mohuar mundësia që të marrin pjesë në procedurë që qoi në përgatitjen e raportit të ekspertizës mjekësore që GjEDNJ e përshkroi si “pjesë të dëshmisë kryesore në rast”, kjo ishte gjetur të përbëjë shkelje të së drejtës për procedurë bazuar në parim të kundërshtimit.¹⁰ Kur, në një rast ku përfshihej një fëmijë që ishte vendosur nën kujdes mbrojtës, dështimi për t'ju dhënë prindërve të fëmijës kopjet e raporteve konfidenciale të punëtorëve social ishte gjetur se ka shkelur të drejtën e tyre për dëgjim bazuar në parim të kundërshtimit. GjEDNJ ka gjetur se:

“Mungesa e shpalosjes së dokumenteve të tilla vitale siç janë raportet e punëtorëve social është në gjendje të ndikojë në mundësinë e pjesëmarrjes së prindërve jo vetëm që të ndikojnë në rezultatin e [gjykimit] por edhe të vlerësojnë mundësitë e të parashtruarit ankesë [...]”¹¹

(2) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF)

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF)¹² përmban dispozita që aplikohen në zhvillimin e procedurës së provave në raste që përfshijnë fëmijë. Neni 12 parasheh se autoritetet:

“do t'i sigurojnë fëmijës i cili është në gjendje të formojë vështrimet e tij apo të saj, të drejtën që t'i shprehin lirshëm ato vështrime në të gjitha çështjet që ndikojnë në fëmijën, duke i dhënë vështrimeve të fëmijës peshën e duhur në pajtim me moshën dhe pjekurinë e fëmijës”,

dhe që:

fëmijës **në veçanti** duhet t'i ofrohet mundësia të dëgjohet në çfarëdo procedure gjyqësore apo administrative që është me ndikim për fëmijën, drejtë për së drejti apo përmes përfaqësuesit ose organit përkatës, në atë mënyrë që të jetë në përputhje me rregullat procedurale të ligjit kombëtar. [Theks i shtuar.]¹³

fakti se paditësit nuk kishin mundësi të përgjigjeshin do të thotë se ata ishin vendosur në situatë të pafavorshme *vis-à-vis* [të paditurve].” (Para. 58)

⁹ Ibid. Shih po ashtu *Feldbrugge kundër Holandës* Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 29 majit 1986, para. 36.

¹⁰ *Mantovanelli kundër Francës*, aktgjykimi i GjEDNJ-së i 17 shkurtit 1997, paragrafët. 30-36. Kjo shkelje nuk mund të korrigjohet thjeshtë duke i a ofruar më vonë paditësit raportin e kompletuar të ekspertit.

¹¹ *McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i GjEDNJ-së, 24 shkurt 1995, A 307-B (1995), 20 EHRR 205, para. 80.

¹² Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Rezoluta e 44/25 e Këshillit të Përgjithshëm të KB-ve, 20 nëntor 1989, hyri në fuqi me 2 shtator 1990 (KDF).

¹³ Ibid. Neni 12.

Në vitin 2009, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës (Komiteti) lëshoi një Koment të Përgjithshëm mbi të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar. Objektivat e Komentit të Përgjithshëm janë që të përforcojë kuptimin e Nenit 12 dhe të propozojë “kushtet elementare për mënyrat e përshtatshme për t'i dhënë peshën e duhur vështrimeve të fëmijëve në të gjitha çështjet që ndikojnë në ta.”¹⁴ Sa i përket “të drejtës së fëmijës që të dëgjohet në procedura gjyqësore civile”, Komiteti vë në dukje se fëmijët duhet të dëgjohen veçanërisht në raste që përshijnë ndarjen dhe shkurorëzimin e prindërve të tyre.¹⁵

(3) Rekomandimet e Këshillit të Evropës

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës rekomandon që gjykatat do të duhej të kenë autoritetin për të ftuar dëshmitarët dhe të vendosin sanksionet e përshtatshme “në rast të mos-paraqitjes të paarsyeshme të dëshmitarëve të tillë”.¹⁶ Lidhur me trajtimin e dëshmitarëve ekspertë, Komiteti i Ministrave rekomandon që:

“[n]jë ekspert i caktuar nga gjykata dështon ta komunikojë raportin e vet apo vonohet ta komunikojë atë pa ndonjë arsye të mirë, atëherë duhet të shqiptohen sanksionet e përshtatshme. Këto mund të marrin formën e reduktimit të pagesës, pagesa e shpenzimeve apo dëmeve si dhe masa disiplinuese të vendosura nga gjykata ose nga ndonjë organizatë profesionale, siç mund të jetë rasti.”¹⁷

Komiteti i Ministrave rekomandon që gjykatat “të luajnë rol aktiv për të siguruar progres të shpejtë në procedurë, përdërisa respektojnë të drejtat e palëve, përfshirë të drejtën për trajtim të barabartë.

“Në veçanti, [gjykatat] duhet të kenë fuqi *proprio motu* për t'i urdhëruar palët që të japin sqarime të tilla siç janë të domosdoshme; të urdhërojnë palët që të paraqiten personalisht; të shtrojnë pyetje lidhur me ligjin; të kërkojnë dëshmi, së paku në ato raste kur ka interesa të tjera përpos atyre të palëve në çështje; të kontrollojnë marrjen e dëshmive; të përjashtojnë dëshmitarët dëshmia e mundshme e të cilëve do të ishte jo-relevante për rastin; të kufizojnë numrin e

¹⁴ Komiteti për të Drejtat e Fëmijës (Komiteti) Komenti i Përgjithshëm Nr. 12 mbi të Drejta e Fëmijëve për t'u Dëgjuar, 20 korrik 2009, para. 8.

¹⁵ Ibid, paragrafët 51-52. Në raste të tilla, Komiteti gjen se, “fëmijët nga marrëdhënia pa mëdyshje ndikohen nga vendimet e gjykatave. Çështjet e mirëmbajtjes së fëmijëve si dhe kujdestaria dhe vizita caktohen nga gjykata ose në gjykim ose përmes ndërmjetësimit të drejtuar nga gjykata. Shumë juridiksione kanë përfshirë në ligjet e tyre, sa i përket shpërbërjes së një marrëdhënieje, një dispozitë që gjyqtari duhet të ketë konsideratë primare për ‘interesat më të mirë të fëmijës’. Për këtë arsye, i tërë legjislacioni mbi ndarjen dhe shkurorëzimin duhet të përfshijë të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar nga vendim-marrësit dhe në procedurën e ndërmjetësimit. Disa juridiksione, ose si çështje e politikës apo e legjislacionit, preferojnë të përcaktojnë moshën për të cilën konsiderohet se fëmija mund t'i shpreh vështrimet e tij apo të saj. Konventa megjithatë parasheh se kjo çështje të përcaktohen në bazë të rastit individual, pasi që i referohet moshës dhe pjekurisë, dhe për këtë arsye kërkohet vlerësim individual i kapacitetit të fëmijës.” Komiteti po ashtu nënvizon se fëmijët duhet të dëgjohen në procedurat e adoptimit dhe mbrojtjes së fëmijëve; shih paragrafët 53-56.

¹⁶ Rekomandimi Nr. R (84)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar Shteteve Anëtare mbi Parimet e Procedurës Civile të Projektuara për të Përmirësuar Funkcionimin e Drejtësisë, 28 shkurt 1984, Parimi 1(3). Më tej, Komiteti i Ministrave nënvizoi, “kur dëshmitari mungon, është në anë të gjykatës të vendos se a do të duhej që rasti të vazhdojë pa dëshminë e tij.”

¹⁷ Ibid, Parimi 1(4).

dëshmitarëve mbi një fakt të veçantë kur një numër i tillë do të ishte i tepërt. Këto fuqi do të duhej të ushtroheshin pa e tejkaluar objektin e shqyrtimit në procedurë.”¹⁸

B) Ligji Vendor

Zhvillimi i fazës së provave në gjykimet civile kryesisht rregullohet përmes Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).¹⁹ Ligjet tjera që përmbajnë dispozita relevante për procedurën e provave përfshijnë Ligjin për Procedurën Jo-Kontestimore (LPJK),²⁰ Ligjin për Familjen,²¹ Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare²² dhe Ligjin kundër Diskriminimit.²³

(1) Dispozitat e Përgjithshme

Palët në rastet civile duhet të paraqesin “të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta” dhe të propozojnë prova të mjaftueshme me të cilat konstatohen secili nga këto fakte.²⁴ Pala duhet të paraqes provat e domosdoshme për të mbështetur faktet që ai apo ajo i pohon dhe po ashtu, kur është e domosdoshme, t’i përgjigjet dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtarë.²⁵ Gjykata duhet të vlerësojë secilën pjesë të dëshmisë së paraqitur “veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”; duhet të vendos mbi pranueshmërinë e provave “në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit”.²⁶ Përveç në disa rrethana të definuara ngushtë, provat duhet të paraqiten në gjykatë gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.²⁷ Provat mund të përfshijnë deklarata verbale të dëshmitarëve (përfshirë edhe palët), dëshmi materiale ose në formë të shkresave, dhe mendim të ekspertëve. Gjykata mund të merr vërejtje gjyqësore, pa pasur nevojë që të

¹⁸ Ibid, Parimi 3.

¹⁹ Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, 20 shtator 2008, të cilin gjykatat filluan ta zbatojnë me 6 tetor 2008. Shih po ashtu Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë 4/1977, 36/1980 dhe 66/1982 të 12 shkurtit 1982 me amendamente të vitit 1998 (ligji për procedurën kontestimore i vitit 1982). Shumë dispozita në LPK mbesin përmbajtësish të njëjta me ato në ligjin për procedurën kontestimore të vitit 1982.

²⁰ Ligji për Procedurën Jo-Kontestimore, Nr. 3/L-007, 13 dhjetor 2008, të cilin gjykatat në Kosovë filluan ta zbatojnë me 28 janar 2009. Shih po ashtu Ligjin për Procedurën Jo-Kontestimore, Nr 42/1986, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Shumë dispozita në LPJK mbesin përmbajtësish të njëjta me ato në ligjin e vitit 1986.

²¹ Ligji Nr. 2004/32 për Familjen, e shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2006/7, 16 shkurt 2006 (Ligji për Familjen). Neni 84(2), për shembull, parasheh se kur bashkëshortët parashetrojnë propozim për shkurorezim me marrëveshje të ndërsjellë, gjykata mund “t’i hetojë faktet dhe ta zbatojë procedurën e provave rreth pjesës së propozimit të bashkëshortëve që ka të bëjë me ruajtjen, edukimin dhe mbajtjen financiare të fëmijëve, nëse bindet se propozimi i prindërve lidhur me këto çështje nuk ofron garanci të nevojshme se interesat e fëmijëve të tyre të mitur ose të paafitë me këtë marrëveshje do të mbrohen në masë të duhur.”

²² Ligji Nr. 2005/02-L17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, e shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2005/46, 21 prill 2005.

²³ Ligji Nr. 2004/3 kundër Diskriminimit, e shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/32, 20 gusht 2004. Neni 8(1) i këtij ligji krijon një barrë të kundërt të provave, ku parasheh se kur paditësi përcakton “faktet [...], nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë”, atëherë barra bie mbi të paditurin për të dëshmuar se “se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.”

²⁴ Neni 7(1), LPK. Shih po ashtu Nenin 319.

²⁵ Neni 428(1), LPK.

²⁶ Neni 8(1) dhe 8(2), LPK. Shih po ashtu Nenin 320.

²⁷ Neni 324(1), LPK. Shih po ashtu Nenet 326-327 dhe 427.

paraqiten dëshmi për të provuar ato, lidhur me “faktet e ditura botërisht” e as “faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e mëhershme”.²⁸ Faktet po ashtu mund të pranohen.²⁹ Pala që pohon një fakt bart barrën e të provuarit atë, përpos në rastet kur parashihet ndryshe me ndonjë dispozitë të veçantë.³⁰ Aktgjykimi i lëshuar pas përfundimit të një rasti civil duhet të jetë në formë të shkruar, i arsyetuar, dhe duhet të përfshijë një sqarim të fakteve të përcaktuara nga gjykata lidhur me atë së pse dhe si e kanë bërë atë. Kur faktet janë gjetur si rezultat i provave të nxjerra gjatë rrjedhës së gjykimit, aktgjykimi duhet të specifikojë se cilat kanë qenë dëshmitë që kanë përcaktuar faktet e dhëna dhe si e kanë bërë këtë.³¹

(2) Dëgjimi i dëshmitarëve

Pala që propozon një dëshmitar duhet që paraprakisht ta këshillojë gjykatën lidhur me dëshminë që dëshmitari pritët ta jep.³² Në disa rrethana të definuara ngushtë, dëshmitari mund të refuzojë të jep dëshmi,³³ ose të përgjigjet në disa pyetje që i parashtrihen atij apo asaj.³⁴ Dëshmitarët nën moshën 14 vjeçare duhet të ftohen përmes prindit apo kujdestarit ligjor.³⁵ Dëshmitarët që nuk mund të paraqiten pranë gjykatës për shkak të “të moshës së shtyrë, sëmundjes ose të metave fizike” mund të dëgjohen diku tjetër.³⁶ Kur ka më shumë se një dëshmitar në një rast, dëshmitarët do të dëgjohen ndaras nga njëri tjetri.³⁷ Dëshmitarët së pari do të dëgjohen nga pala në të mirë të së cilës janë ftuar e më pas nga pala kundërshtare.³⁸ Dëshmitarët duhet gjithmonë të pyeten se si kanë arritur t’i mësojnë çështjet mbi të cilat dëshmojnë.³⁹ Dëshmitarët mund t’i referohen shënimeve kur “flasim për çështje që kanë të bëjnë me llogari” ose nëse ata dëshmojnë lidhur me të “dhëna që është vështirë të mbahen mend”.⁴⁰ Përkthyesi duhet të sigurohet për “dëshmitari[n] që nuk e dinë gjuhën”.⁴¹ Dëshmitarët kanë të drejtën për kompensim për shpenzimet e udhëtimit, ushqimit, banimit dhe “fitimit të humbur”.⁴²

Edhe pse nuk ka të drejtë automatike për këtë, sipas lirisë së veprimit të gjykatës, palës në një padi civile mund t’i lejohet të dëshmojë në cilësi të dëshmitarit në rastin e tij apo të saj.⁴³ Kur palës i mungon “zotësia procedurale” në vend të tij apo të saj

²⁸ Neni 321(1), LPK.

²⁹ Neni 321(2), LPK.

³⁰ Neni 322, LPK.

³¹ Neni 160(4), LPK.

³² Neni 340, LPK. Pala gjithashtu duhet të jep emrin dhe adresën e plotë të dëshmitarit.

³³ Nenet 341-342, LPK.

³⁴ Neni 343, LPK.

³⁵ Neni 345(2), LPK.

³⁶ Neni 346(3), LPK.

³⁷ Neni 347(1), LPK.

³⁸ Neni 348(1), LPK. Kur është e nevojshme, pala që ka ftuar dëshmitarin mund të lejohet që t’i parashtrijë dëshmitarit pyetje shtesë pas dëgjimit: Neni 431(2). Veç kësaj, gjykata mund t’i parashtrijë pyetje dëshmitarit në çfarëdo kohe: Neni 348(2) (shih po ashtu Nenin 432, i cili parasheh se gjykata mund t’i bëjë pyetje “palëve, dëshmitarëve apo ekspertëve në të gjitha fazat” e gjykimit.”)

³⁹ Neni 348(3), LPK.

⁴⁰ Neni 353, LPK.

⁴¹ Neni 354(1), LPK. Nëse dëshmitari është i shurdhër apo/ose memec, ai apo ajo mund që me shkrim t’i përgjigjet pyetjeve, ose si alternativë përmes interpretit: Neni 354(2)

⁴² Neni 355(1), LPK. Gjykata është e obliguar që t’i informojë dëshmitarët lidhur me këtë të drejtë, e cila do të humbet po që se nuk ushtrohet “menjëherë pasi të pyetet”: Neni 355(2).

⁴³ Neni 373, LPK.

mund të dëshmoj përfaqësuesi ligjor.⁴⁴ Në rastet kur pala është “person juridik”, atëherë “dëgjohej personi që është i caktuar për përfaqësimin e tij me ligj” si dëshmitarë.⁴⁵ Pala që dëshmon do të dëgjohej së pari nga avokati i tij apo saj e më pas nga pala kundërshtare.⁴⁶ Sa i përket dëgjimit të fëmijëve si dëshmitarë, Ligji për Familjen parasheh se gjykata duhet të merr vendim për “ushtrimin e të drejtave dhe detyrave prindërore”, dhe do të merr parasysh “mendimi[n] [e] fëmijës, i cili është i aftë të japë pikëpamjet e tij/saj”.⁴⁷

(3) Dëshmitë materiale dhe shkresat

Palët duhet të paraqesin cilëndo shkresë të nevojshme për të mbështetur deklaratimet që ata i japin në lidhje me rastin.⁴⁸ Kur pala pandeh se pala kundërshtare është në posedim të cilësdo “shkrese”, gjykata mund ta urdhërojë palën kundërshtare që ta paraqes atë shkresë.⁴⁹ Gjukata po ashtu mund t’i urdhërojë palët e treta që të paraqesin shkresa që janë në posedim të tyre, kur shkresat e tilla janë relevante për rastin.⁵⁰ Në disa procedura jo-kontestimore, palët janë të obliguara që padisë së parashtuar t’i bashkëngjisin dëshmitë e nevojshme në formë të shkresave, ose si alternativë, ti sjellin ato me vete kur të vijnë në gjykatë.⁵¹

(4) Dëshmitë e ekspertëve

Me propozim të palëve, gjykata mund të urdhërojë që mendimi i ekspertit të nxjerrët si dëshmi në rast. Gjukata do të bëjë një urdhër të tillë “sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes”.⁵² Pala që bën propozimin për dëshminë në formë të mendimit të ekspertit duhet të sqarojë së pse është e nevojshme ekspertiza dhe duhet të jep emrin e një eksperti. Palës kundërshtare duhet t’i jepet mundësia që të përgjigjet në propozim.⁵³ Përveç në disa fusha të veçanta të ekspertizës, ekspertët duhet të zgjedhën nga lista me të cilën posedon gjykata.⁵⁴ Një dëshmitar ekspert, pas ftesës,

⁴⁴ Neni 375(1), LPK. Megjithatë, gjykata mund të vendos se, përveç dëshmisë së përfaqësuesit ligjor, “të pyetet vetë pala, po që se është i mundshëm dëgjimi i saj”:Neni 375(2).

⁴⁵ Neni 375(3), LPK.

⁴⁶ Neni 430(1), LPK. Kur pala që dëshmon nuk përfaqësohet nga avokati, ai apo ajo do të jetë i/e para që të merret në pyetje nga gjykata: Neni 430(2). Siç është rasti me dëshmitarët tjerë, pala që dëshmon mund të merret në pyetje nga gjykata “në të gjitha fazat e marrjes në pyetje: Neni 432.

⁴⁷ Neni 140(5), Ligji për Familjen. “Mendimit të tij do t’i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.”

⁴⁸ Neni 331, LPK.

⁴⁹ Neni 333, LPK.

⁵⁰ Nenet 337-338, LPK. Pala e tretë mund të kërkojë kompensim nëse i shkaktohen shpenzime në sigurimin e shkresave të tilla.

⁵¹ Shih, *inter alia*, Nenin 198(2), LPJK, i cili kërkon nga palët që parashtrajnë propozim të përbashkët për ndarjen e pronës së përbashkët që të ja bashkëngjisin propozimit të tyre “provat mbi të drejtën e pronësisë, të drejtën e servitutit dhe të drejtat e tjera sendore, si dhe për posedimin e paluajtshmërisë.” Shih po ashtu Nenin 207, LPJK, i cili parasheh që, me qëllim që të arrihet marrëveshje për caktimin e megjës, gjykata mund t’i “udhëzoj[ë]” palët që t’i “sjellin të gjitha dokumentet, skicat dhe provat tjera me rëndësi për rregullimin e megjës.”

⁵² Neni 356, LPK. Shih po ashtu Nenin 358(2), i cili parasheh që gjykata mund “t’i caktojë më tepër ekspertë për lloje të ndryshme ekspertizash.”

⁵³ Neni 357, LPK. Nëse palët nuk mund të merren vesh lidhur me ekspertin, atëherë gjykata do të vendos.

⁵⁴ Neni 358, LPK. “Ekspertizat me të ndërlikuara” duhet t’i “besohen në rend të parë institucioneve profesionale (spitaleve, laboratorëve kimike, fakulteteve etj).” Kur ekzistojnë “institucionet e

duhet “t’i përgjigjet thirrjes së gjykatës dhe të parashtrijë konstatimin dhe mendimin e tij”⁵⁵ dhe duhet që sinqerisht ta jep mendimin e ti apo të saj “dhe në pajtim me rregullat e shkencës dhe profesionit”.⁵⁶

Ekspertëve duhet t’u shpjegohet çështja për të cilën kërkohet ekspertiza e tyre dhe duhet t’u jepet mundësia që të “të marrë pjesë në seancë gjyqësore, të bëjë pyetje, të japë shpjegime dhe të kërkojë nga palët të marrë të dhëna si dhe nga të tretët brenda kufijve të nevojshëm” lidhur me çështjet.⁵⁷ Përpos nëse gjykata vendos ndryshe, eksperti duhet ta jep mendimin e tij apo të saj në formë të shkruar “para së të filloj seanca për shqyrtimin kryesor”. Mendimi me shkrim duhet të jetë “i arsytuar”.⁵⁸ Kur më shumë se një ekspert është i përfshirë në një rast, ekspertët mund “ta paraqesin konstatimin dhe mendimin e përbashkët po që se nuk ka dallime midis tyre.” Megjithatë, kur mendimet e tyre janë të kundërt me njëri tjetrin, ekspertët duhet të paraqesin raporte të ndara.⁵⁹ Palët kanë të drejtën të pranojnë një kopje të raportit të ekspertit “së paku shtatë (7) ditë para se të mbahet seanca për shqyrtimin kryesor.”⁶⁰

LPJK parashih dispozita të veçanta në lidhje me shfrytëzimin e mendimit të ekspertit si dëshmi në procedurat që përfshijnë heqjen e zotësisë ligjore të individit si rezultat i paaftësisë mendore. Në raste të tilla, individ i cili është objekt shqyrtimi në procedurë duhet të vlerësohet nga “tre ekspert shëndetësor të specializimit përkatës [të cilët] do ta [japin] konstatimin dhe mendimin me shkrim për gjendjen psikike dhe aftësinë [...]për të gjykuar.” Veç kësaj, këto vlerësime të ekspertit duhet të bëhen “në praninë e gjykatës”, përpos në rastet kur ato kryhen në “institucionin shëndetësor.”⁶¹

Në rastet e shkurorëzimeve, kur prindërit nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë marrëveshje lidhur me çështjet për “ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur”, ose kur marrëveshja e arritur nuk “u përgjigjet interesave të fëmijëve”, Ligji për Familjen kërkon nga gjykata që të dëgjojë “mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë” para se të merr vendimin.⁶² Në rastet që përfshijnë heqjen e kujdestarisë për fëmijën nga kujdesi prindëror për shkak të keqpërdorimit ose neglizhencës, Ligji për Familjen kërkon nga gjykata që para se të merr vendimin, të dëgjojë “mendimin nga Organi i Kujdestarisë”.⁶³ Në rastet që përfshijnë adoptimin e fëmijëve, gjykata

specializuara për llojet e caktuara ekspertizash (ekspertiza e monedhave të falsifikuara, e dorëshkrimeve, mandej ekspertiza daktiloskopike etj)”, atëherë do të ftohen dëshmitarët ekspertë nga ato institucione.

⁵⁵ Neni 359(1), LPK. Eksperti mund të lirohet nga dhënia e dëshmisë pasi të jep arsye të besueshme se pse ai apo ajo nuk mund “të dëshmojë, ose që të japë përgjigje në ndonjë pyetje.”

⁵⁶ Neni 362(3), LPK.

⁵⁷ Neni 363(1), LPK.

⁵⁸ Neni 364, LPK.

⁵⁹ Neni 369, LPK.

⁶⁰ Neni 407(2), LPK. Shih po ashtu Nenin 367, LPK, i cili duket të parashih se palët duhet të pranojnë nga një kopje të raportit të ekspertit “së paku tetë (7) ditë para se të mbahet seanca për shqyrtimin kryesor.”

⁶¹ Neni 40, LPJK.

⁶² Neni 140(2), Ligji për Familjen. Ngjashëm, Neni 143(2) i Ligjit për Familjen parashih që gjykata duhet të dëgjojë “mendimi[n] dhe propozimi[n] [...]nga Organi i Kujdestarisë” para se të merr vendimin në kontestet ndërmjet prindërve të fëmijës dhe personit të tretë të cilit i është besuar fëmija. Shih po ashtu Nenin 14, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

⁶³ Neni 149(3), Ligji për Familjen.

mund të kërkojë mendimin e Organit të Kujdestarisë.⁶⁴ Në vlerësimin lidhur me “përshtatshmërinë e adoptuesit dhe të adoptuarit”, Gjykata duhet “të marrë parasysh të gjitha mendimet e arsyetuara të sociologut, psikologëve, mjekut, dhe të ekspertëve tjerë”.⁶⁵

(5) Pushteti për të vendosur sanksione ndaj dëshmitarëve apo ekspertëve jobashkëpunues

LPK parasheh vendosjen e sanksioneve në rrethanat kur dëshmitarët, përfshirë edhe dëshmitarët ekspertë, dështojnë të veprojnë në pajtim me urdhrat e gjykatës. Kur dëshmitari i ftuar, pa arsytim dështon të paraqitet para gjykatës, ai apo ajo do të arrestohet dhe të silllet pranë gjykatës “me forcë”, dhe do të gjobitet me 500 Euro.⁶⁶ Kur dëshmitari paraqitet pranë gjykatës por pa arsytim refuzon, që të dëshmojë apo të përgjigjet në “pyetjet konkrete”, ai apo ajo do të gjobitet “deri në” 500 Euro dhe mund të burgoset për jo më tepër se 30 ditë.⁶⁷ Kur dëshmitari ekspert dështon, pa arsytim, të ofrojë mendimin e tij apo saj brenda afatit të caktuar nga gjykata, ose pa arsytim dështon të paraqitet pranë gjykatës, ai apo ajo mund të gjobitet “deri në” 1,000 Euro.⁶⁸ Gjykata po ashtu mund të shqiptojë gjobë “deri në” 1,000 Euro ndaj ekspertit i cili “pa ndonjë arsye refuzon ekspertimin”.⁶⁹

3. PROCEDURA E PROVAVE NË RASTET CIVILE NË KOSOVË

OSBE ka vërejtur një numër mangësish serioze në zhvillimin e procedurës së provave në rastet civile të shqyrtuara pranë gjykatave në Kosovë. Këto përfshijnë mangësi në mënyrën se si dëgjohen dëshmitarët dhe si nxjerrën dëshmitë, si dhe shkelje në menaxhimin e procedurës së dëshmive të ekspertëve.

A) Dëgjimi i deklaratave të dëshmitarëve

Shembuj të zakonshëm të çështjeve problematike lidhur me prova në veçanti dalin nga procedurat gjyqësore familjare pranë gjykatave në Kosovë, siç janë parë në shembujt e rasteve të detajuara më poshtë.

Paditësja parashtroi një padi me të cilën kërkonte kujdestarinë për fëmijët në atë kohë të moshës katër dhe gjashtë vjeçare, që kishin lindur nga marrëdhënia e saj me të paditurin. Paditësja pohoi se i padituri e kishte keqtrajtuar fizikisht gjatë marrëdhënies së tyre dhe se e kishte shtyrë t’i nënshtrohej një aborti.

⁶⁴ Neni 161(1), Ligji për Familjen. Vë re se këtu, përfshirja e Organit të Kujdestarisë është më shumë çështje e lirisë së veprimit të gjykatës sesa obligative. Neni 182(3) i Ligjit për Familjen parasheh se gjykata po ashtu, sipas lirisë së vet të veprimit mund të “mbledhë të dhëna dhe dëshmi të tjera nga organi i kujdestarisë, nga shërbimet shoqërore dhe nga ekspert të tjerë në lëmin e përkujdesjes së fëmijës mbi kushtet e adoptimit”.

⁶⁵ Neni 184(1), Ligji për Familjen.

⁶⁶ Neni 292(1), LPK. Neni 294, LPK parasheh se dëshmitari i cili dështon të paguajë gjobën brenda afatit të lejuar do të jetë objekt për shqiptim dënimi me burg për jo më tepër se 30 ditë.

⁶⁷ Neni 292(2), LPK.

⁶⁸ Neni 293(1), LPK. Për dallim nga Neni 292, kjo dispozitë është në liri të veprimit të gjykatës.

⁶⁹ Neni 293(2), LPK. Gjykata po ashtu mund të urdhërojë, me kërkesë të palës së prekur, që dëshmitari ekspert të paguaj çfarëdo shpenzimi që del nga dështimi i tij apo i saj që të jap mendimin, apo refuzimit të tij apo të saj për të bërë ekspertizën: Neni 293(3).

Paditësja kërkoi që si asaj ashtu edhe të dy fëmijëve t'i jepet mundësia të dëgjohen. I padituri mohoi pohimet e paditëses dhe deklaroi se paditësja mund të ketë vuajtur nga ndonjë sëmundje psikiatrike; ai po ashtu pandehi se ishte kërcënuar nga vëllezërit e paditëses. Vetëm i padituri dëshmoi gjatë seancës dëgjimore; paditësja edhe pse e përfaqësuar nga avokati që ishte i pranishëm gjatë seancës dëgjimore, vet nuk ishte e pranishme gjatë kësaj seance. Gjykata kurrë nuk lëshoi një vendim lidhur me kërkesën e paditëses për t'u lejuar që ajo dhe fëmijët të dëgjohen. Pasi që përfundoi seanca dëgjimore, gjyqtari deklaroi se ai do të kontaktojë policinë “përmes kanaleve zyrtare të gjykatës” për të konstatuar se a mbështeste policia versionin e ngjarjeve të dhënë nga i padituri *vis-à-vis* kërcënimit të pandehur nga ana e vëllezërve të paditëses. Në aktgjykimin që pasoi, me të cilin kërkesa e paditëses për kujdestari refuzohej, gjyqtari nënvizoi se dëshmia e të paditurit ishte mbështetur me “parashtresën e ofruar nga stacionin policor [...]”.

Ky rast zbulon tri mangësi serioze në zhvillimin e procedurës së provave. E para përfshin dështimin e gjykatës për ta marr parasysh kërkesën e paditëses për t'u dëgjuar si dëshmitare në rast. Duke pasur parasysh se çfarë ndodhej përpara – kujdestaria e dy fëmijëve të vegjël – dhe veç kësaj duke pasur parasysh pohimet serioze të bëra nga palët, është e vështirë të imagjinohet se si ka mundur të vendoset drejtë rasti në mungesë të dëshmisë së detajuar lidhur me ato pohime, si nga paditësja ashtu edhe nga i padituri. Gjykata dëgjoi dëshminë vetëm nga njëra prej dy palëve – nga i padituri – dhe përfundimisht vendosi në të mirë të tij.

Mangësia e dytë përfshin dështimin e gjykatës për të marr parasysh kërkesën e paditëses që të dëgjohen fëmijët. Duke pasur parasysh moshën e re të tyre, mbase ka pak gjasa që gjykata mund të ketë vendosur që të dëgjojë ndonjërin nga ata si dëshmitarë; megjithatë, gjykata ka qenë e obliguar që të merr parasysh kërkesën dhe të vendos lidhur me të, dhe dështoi ta bëjë këtë.

Së treti, nga shqetësimet më serioze ishte veprimi i njëanshëm i gjyqtarit - i ndërmarr *pasi që* pjesa provuese e gjykimit kishte përfunduar – që të kontaktojë policinë dhe të kërkojë dëshminë prej saj në lidhje me një çështje që kishte të bëjë me rastit. Çështja ishte ajo të cilën gjyqtari e konsideroi të rëndësishme për të marr vendimin e tij; në fakt, u dëshmuar të jetë çështja që ishte vendimtare për rezultatin e rastit në tërësi. Si e tillë, palët qartazi kishin të drejtën për t'u përballur me këtë dëshmi dhe të përgjigjen në të.

Mangësi gjatë procedurës së provave ishin vërejtur po ashtu në rastin më poshtë

Paditësi parashtroi një padi pranë gjykatës së qarkut me të cilën kërkonte shpërbërjen e martesës së tij me të paditurën, dhe kërkonte që gjykata të ja besojë të paditurës kujdesin për katër vajzat e qiftit të moshave prej 14 deri në 18 vjeç. E paditura kundërshtoi shkurorëzimin dhe kërkoi nga gjykata të zhvillojë procedurën e pajtimit. Ajo po ashtu parashtroi një kundër-padi me të cilën kërkonte alimentacion prej 500 Euro në muaj për mbështetjen e saj dhe vajzave të saj, në mënyrë retroaktive nga data që kur paditësi e braktisi të paditurën. Në seancën e shqyrtimit kryesor, avokati i paditësit i tha gjykatës se paditësi jetonte në Austri në një lidhje jashtë-martesorë në të cilën ishte bërë baba i katër fëmijëve tjerë; andaj, siç argumentoi avokati i tij, paditësi nuk ka

mundësi të paguajë shumën e alimentacionit që e paditura kërkonte, por ishte i pajtimit të paguajë 200 Euro në muaj. E paditura deklaroi se, nga paditësi duhet të kërkohet që të paraqes dëshmi në mbështetje të këtyre pohimeve. Ajo po ashtu kërkoi që të lejohet të dëshmojë në cilësi të dëshmitares dhe që i ati dhe kushëriri i saj të ftohen që të japin dëshmi në rast. Gjykata miratoi kërkesat e saj dhe dërgoi ftesat për të atin dhe kushëririn. Kur seanca e shqyrtimit kryesor u rihap me qëllim të nxjerrjes së provave, e paditura dhe kushëriri i saj u paraqiten dhe dhanë dëshmi. I ati i të paditurës, edhe pse i ftuar, nuk u paraqit dhe asnjë sqarim nuk ishte dhënë për të arsyetuar mungesën e tij. Menjëherë pas kësaj seance, gjykata lëshoi aktgjykimin me të cilin u prish martesë dhe i besoi të paditurës kujdesin për fëmijët. Gjykata urdhëroi paditësin që t'ia paguajë të paditurës alimentacionin në shumë prej 350 Eurove në muaj.

Paditësi në këtë rast bëri disa pohime të cilat ishin potencialisht relevante sa i përket mundësisë së tij për të paguar alimentacionin. Megjithatë, këto pohime nuk u mbështetën me asnjë dëshmi; paditësi as nuk parashtrroi dëshmi në formë të shkresave e as nuk u paraqit para gjykatës për të dëshmuar. Si rezultat, gjykata pranë vetes kishte vetëm dëshminë e të paditurës kur vendosi lidhur me shumën e alimentacionit që paditësi detyrohej ta paguajë. Gjykata ka mundur të shtyjë procedurën dhe të urdhërojë që paditësi ose të parashtrrojë dëshmi në formë të shkresave apo të paraqitet për të dëshmuar, por nuk e bëri këtë. Përkundër mungesës së çfarëdo dëshmie që do të mbështeste versionin e ngjarjeve sipas paditësit, gjykata përfundimisht vendosi që në efekt të “ndajë dallimin” ndërmjet shumës së ofruar nga paditësi dhe shumës së kërkuar nga e paditura. Gjykata në këtë rast po ashtu dështoi të shfrytëzoj ndonjë nga mjetet që kishte në dispozicion për të trajtuar mos-paraqitjen e të atit të së paditurës si dëshmitar.⁷⁰

B) Provat në formë të shkresave

OSBE ka vërejtur se mangësitë në procedurën e provave shpesh ndërlidhen me parashtrimin e provave në formë të shkresave. Në veçanti, shembujt e rasteve demonstrojnë dështimin e gjykatave që në mënyrë të duhur të menaxhojnë procesin përmes të cilit administrohen provat në formë të shkresave, dështimin për të vlerësuar sa janë relevante shkresat në kohën kur palët kërkojnë që ato të nxjerrën si prova, dhe ndonjëherë, dështimi që në mënyrë të duhur të bëhet dallimi ndërmjet shkresave të cilat janë administruar si prova dhe atyre që thjeshtë janë parashtruar nga palët për të formuar një pjesë të shkresave të lëndës.

Paditësi parashtrroi një mocion kundër punëdhënësit të tij për shkarkim të padrejtë nga puna e tij. Palët, si dhe disa dëshmitarë, dëshmuar gjatë rrjedhës së tri seancave dëgjimore. Shkresat e kësaj lënde përmbanin një numër të madh dokumentesh të cilat ishin parashtrua nga i padituri. Këto dokumente të cilat kurrë nuk ishin administruar si prova në procedurë, përfshinin kontrata të punës, deklarata të dëshmitarëve, një letër vërejtjeje dërguar paditësit nga punëdhënësi, procesverbali nga një raport i përpiluar nga Inspektorati për

⁷⁰ Siç është nënvizuar në faqet 8-9 të këtij raporti, LPK parashih se kur dëshmitari pa arsyetim dështon të paraqitet para gjykatës, përkundër asaj që është ftuar në mënyrë të rregullt, ai do të silltet me forcë para gjykatës dhe do të gjobitet me 500 Euro.

Arsim, raportin e vlerësimit nga punëdhënësi, vendimi për t'i anuluar notat e dhëna nga paditësi nxënësve të tij, vendimi nga Inspektorati për të iniciuar procedurë disiplinuese kundër paditësit, dhe vendimi i punëdhënësit në mbështetje të shkarkimit nga puna. Aktgjykimi ishte lëshuar në dhjetor të vitit 2010 me të cilin refuzohej padia. Në të, gjykata referohet që “kishte shqyrtuar të gjithat provat” edhe pse aktgjykimi nuk veçon se cilat prova i kishte shqyrtuar gjyqtari, dhe nuk bën asnjë referim të veçantë në ndonjë dokument nga shkresat e lëndës. Megjithatë, është e dukshme nga leximi i aktgjykimit që gjyqtari morri parasysh së paku disa nga këto shkresa kur vendosi lidhur me rastin përkundër faktit se asnjë nga ato asnjëherë nuk ishte administruar zyrtarisht si provë.

Praktika gjyqësore e GjEDNJ-së e bën të qartë se të gjitha provat duhet të “parashtrihen në prani të [palëve] gjatë dëgjimit publik me këndvështrim nga argumenti kundërshtues”.⁷¹ Dokumentet në këtë shembull të rastit kurrë nuk ishin nxjerrë si prova në prani të paditësit; si rezultat, ai ishte privuar nga mundësia që të përgjigjet në to gjatë rrjedhës së procedurës, ose si dëshmi ose përmes fjalimit të tij përfundimtar. Ka gjasa që fakti se ai nuk ishte në gjendje të përgjigjet kësi soj e vendosi atë në pozitë të pafavorshme *vis-à-vis* të paditurit. Si e tillë, ishte komprometuar e drejta e tij për gjykim bazuar në parim të kundërshtimit.

Paditësi inicioi një mocion për të dëbuar të paditurin nga banesa të cilën ai e kishte zënë për 20 vite. Paditësi tha se banesa i ishte ndarë atij pas luftës. I padituri tha se nuk kishte marrë kurrfarë njoftimi lidhur me këtë ndarje, dhe pohoi se ai kishte banuar në banesë – e cila i ishte ndarë nga punëdhënësi i tij – si para ashtu edhe pas lufte. Gjatë procedurës së provave, një numër i konsiderueshëm i dokumenteve ishin nxjerrë si prova, dhe disa nga to ishin kundërshtuar në baza se sa ishin relevante për rastin. Përkundër kërkesave të përsëritura, gjyqtari refuzoi të vendos lidhur me ndonjë nga këto kundërshtime, duke i këshilluar palët se ai do të vendos se sa ishin këto dokumente relevante në kohën kur do të përpiloj aktgjykimin.

Pa ditur se a do të konsiderohet përfundimisht një pjesë e dëshmisë si relevante, të dyja palët në shembullin e rastit të mësipërm mund të kenë qenë vendosur në pozitë shumë të pafavorshme *vis-à-vis* palës kundërshtare. Se, për shembull, a do t'i parashtrijnë pyetje dëshmitarëve tjerë lidhur me dokumentin në fjalë? Si do të trajtonin dokumentin e kontestuar në fjalimet e tyre përfundimtare? Dështimi i gjykatës për të vlerësuar se sa janë relevante provat teksa procedohej rasti, dhe për të vendosur përshtatshëm lidhur me prova, ka mundur të paragjykojë seriozisht aftësinë e palëve që t'i paraqesin rastet e tyre në mënyrë efektive.

C) Procedura lidhur me provat në formë të mendimit të ekspertit

Nevoja për dëshmi të ekspertit për të zgjidhur çështjet në një rast civil paraqet sfida të veçanta për gjykatat. Siç do të jetë evidente nga shembulli i rastit të dhënë më poshtë, këto probleme mbase më së miri mund të shikohen kryesisht si çështje lidhur me menaxhim të lëndëve. Pa një qasje rigoroze, pro-aktive në menaxhim të procedurës së

⁷¹ Fusnota e sipërme, 10.

provave të ekspertëve në paditë civile, përfshirja e ekspertizës ka mundësi që t'i kontribuojë vonesave të konsiderueshme në zgjidhjen e rasteve.

Në tetor të vitit 2004, paditësi parashtrori një mocion pranë gjykatës së qarkut me të cilin kërkonte kompensim për shkelje të pandehur të të drejtave të autorit nga ana e të paditurit. Në një aktgjykim të lëshuar në nëntor të vitit 2005, gjykata e qarkut e pranoi pjesërisht padinë dhe i shpërbleu paditësit dëmin në shumë prej 44,300 Euro. Paditësi parashtrori ankesë në Gjykatën Supreme për pjesët e padisë të cilat nuk ishin pranuar nga gjykata e qarkut. I padituri nga ana tjetër parashtrori ankesë për çështje të interpretimit ligjor dhe faktik. Në dhjetor të vitit, Gjykata Supreme lëshoi një aktgjykim me të cilin pjesërisht lejonte të dy ankesat dhe dërgoi rastin prapa në gjykatë të qarkut për rigjykim. Gjykata Supreme kishte dhënë vështrimin që dëshmitarë ekspertë të caktohen nga gjykata e qarkut për të dhënë mendime si lidhur me çështjen e shkeljes së të drejtave autoriale ashtu edhe me atë të dëmit financiar. Gjykata e qarkut ri-mblodhi seancën dëgjimore në rast në nëntor të vitit 2008 dhe vendosi të caktojë dëshmitarë ekspertë në pajtim me vështrimet e Gjykatës Supreme; seanca ishte shtyrë deri atëherë kur ekspertët të parashtrorjës mendimet e tyre. Në nëntor të vitit 2009, gjykata caktoi si dëshmitarë ekspertë në rast, një skenarist dhe një ekspert financiar. Skenaristi brenda disa ditëve pasi që ishte angazhuar, parashtrori pranë gjykatës mendimin e ekspertit. Në qershor të vitit 2010, një gjyqtar i ri ishte caktuar për të trajtuar rastin. Në korrik të vitit 2010, eksperti financiar solli parashtrësën e vet para gjyqtarit të ri me të cilën konstatoi se ai nuk kishte qenë në gjendje të ofrojë mendimin e kërkuar të ekspertit. Në shtator të vitit 2010, gjyqtari i ri caktoi një tjetër ekspert financiar dhe kërkoi nga ai që të jep një mendim. Ky dëshmitar ekspert parashtrori mendimin e ekspertit brenda dy muajsh. Një seancë dëgjimore u mbledh më mars të vitit 2011 në të cilën i padituri kundërshtoi të dy mendimet e ekspertëve, duke argumentuar se mendimi i skenaristit ishte “i paqartë dhe joprofesional”, dhe se mendimi i ekspertit financiar ishte subjektiv pasi që raportet e tilla janë “normalisht reflektimi i [mendimit] të ekspertit për të drejtat autoriale.” I padituri kërkoi pushim për të ftuar një dëshmitarë tjetër për të qartësuar gjetjet faktike të mendimit të skenaristit. Gjykata aprovoi kërkesën e të paditurin dhe seanca ishte shtyrë sërish.

Në rastin e mësipërm, procedura është zvarritur për afro shtatë vite deri më këtë datë. Vonesa në zgjidhjen e rastit i atribuohet një numër faktorësh. Megjithatë, çështjet lidhur me dhënien e dëshmisë në formë të mendimit të ekspertëve, qartë kanë qenë faktori primar që prej nëntorit 2008; në të vërtetë, vonesa ndërmjet nëntorit 2008 dhe korrikut 2010, një periudhë prej diku 20 muajve është një shqetësim i veçantë. Nuk është e qartë, për shembull, se pse eksperti i parë financiar refuzoi që të jep mendimin e kërkuar të ekspertit, e as pse nuk e kishte deklaruar paaftësinë e tij për ta bërë këtë deri në korrik të vitit 2010. Nuk është e mundshme të thuhet nga dosja e gjykatës se a ka marr gjykata parasysh që ta gjobis këtë ekspert për refuzimin që të jep mendimin për të cilin ai ishte caktuar.⁷² Veç kësaj, nuk është e qartë se pse kundërshtimet e të paditurit ndaj mendimeve të ekspertëve nuk ishin bërë në një mënyrë më të shpejtë. Duke lejuar të paditurin të parashtrorjës kundërshtime ndaj këtyre mendimeve të

⁷² Siç është nënvizuar më herët në këtë raport, gjykata mund të shqiptojë gjobë deri në 1,000 Euro ndaj ekspertit i cili “pa arsye refuzon të bëjë ekspertizën”: shih më lartë në fusnotën 71.

ekspertëve për herë të parë në një seancë që u mbajt shumë muaj pas marrjes së mendimeve, gjykata në heshtje pranoi të shtyjë procedurën akoma më tej. Ka gjasa që një qasje më rigoroze dhe pro-aktive nga ana e gjykatës për të menaxhuar procedurën e provave të ekspertit në këtë rast, në një masë do të minimizonte vonesën.

Dëshmi në formë të ekspertizës mjekësore kërkohen në procedurat që kanë të bëjnë me heqjen e zotësisë juridike të një personi,⁷³ si rezultat i paaftësisë mendore. Për shkak të ndjeshmërisë së posaçme të personit që është objekt shqyrtimi në këso lloj procedurash dhe rëndësisë së madhe të asaj me çfarë ballafaqohet, kushtet e caktuara me ligj duhet të përfillen me nder. Megjithatë, siç demonstroi shembulli i rastit në vijim kjo shpesh nuk shihet në praktikë.

Qendra për Punë Sociale (QPS) parashtrori një shkresë para një gjykate komunale me të cilën kërkonte heqjen e zotësisë juridike të “një personi pa kujdes familjar”, dhe, si “masë urgjente”, shtrirjen e tij në Qendrën për Shëndet Mendor në Shtime/Štimlje. Asnjë vlerësim mjekësor apo ekspertizë e çfarëdo lloji nuk ju kishte bashkëngjitur kërkesës e as më vonë nuk ju shkresave të lëndës. Me kërkesë pohohej se individ i ishte “i papërshtatshëm,” “ndalon punën e zyrtarëve si dhe të qytetarëve në fqinjësi,” “nuk pastrohet” dhe “mund të shpërndaj ndonjë lloj sëmundje.” I vetmi dokumentacion mbështetës i parashtruar me shkresë ishte një kërkesë veprimi prej bizneseve që operonin në rajon. Ditën pasi që ishte parashtruar kërkesa, gjykata mbledhi seancën dëgjimore. Pjesëmarrës në seancë ishte një avokat që përfaqësonte QPS-në dhe një neuro-psikiatër i cili me sa duket ishte angazhuar nga QPS-ja. Personi për të cilin shqyrtohej çështja nuk ishte i pranishëm; gjykata vuri në dukje se ai nuk ka mund të sillet pranë gjykatës “për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.” Gjatë seancës, neuro-psikiatri dha një deklaratë bazuar në atë që ai kishte përshkruar si një “vizitë” që ja kishte bërë personit më herët atë ditë, së bashku me një punëtor social. Ai dëshmoi se personi në pyetje ishte:

“Person i retarduar mentalisht në shkallë të mesme të rëndë i cili nuk ka kujdes familjar dhe shoqëror. Ai brend rrugëve [...]. Ai ka flokë të gjatë të pakrehur, mjekër të gjatë, mban rrobe tejet të përlyera, higjienë personale shumë e ulët. Ai nuk dëshiron fare të komunikojë, tymos shumë duhan dhe ulet në shkallë të [një ndërtese në fqinjësi].

“Të dhëna nga punëtori social tregojnë se banorët dhe pronarët e dyqaneve [në] fqinjësi disa herë kanë kërkuar që të gjendet një zgjidhje dhe që disa ai të largohet nga aty në mënyrë që të mos i frikësojë fëmijët e tyre”.

“Pasi që [personi në pyetje] nuk ka kapacitet intelektual që të kujdeset për vete dhe t’i mbrojë interesat e veta, i propozojë Gjykatës që t’i heq zotësinë për të vepruar tërësisht dhe përgjithmonë. Ai ka nevojë për kujdes social nga një Institut Special (social apo shëndetësor).”

Në përmbyllje të procedurës së provave, gjykata vendosi që personit të ia heq zotësinë juridike. Në arsyet e veta, gjykata nënvizoi se vendimi ishte “bazuar

⁷³ Shih fusnotën e sipërme 64.

në mendimin e eksperti neuro-psikiatër dhe dëshmitë e ofruara nga [...] QPS. Menjëherë pas vendimit, gjykata lëshoi një urdhër për policinë që “urgjentisht ta dërgojë [personin] e sëmurë mendor në Institutin Special për shëndet në Shtime/Štimlje, pasi që ai rrezikon veten e tij dhe njerëzit përreth tij.”

Në një procedurë që përfshin heqjen e zotësisë juridike të një individi, ligji shprehimisht parasheh që personi i cili është objekt shqyrtimi në procedurë duhet të vlerësohet nga “tre ekspert shëndetësor të specializimit përkatës [të cilët do ta japin] konstatimin dhe mendimin me shkrim për gjendjen psikike dhe aftësinë [...] për të gjykuar.” Ligji po ashtu është i qartë që këto vlerësime të ekspertëve duhet të bëhen “në praninë e gjykatësit”, përpos kur ato zhvillohen në “institucionin shëndetësor”.⁷⁴ Provat e nxjerra në rastin e mësipërm nuk kanë përmbushur asnjë nga këto kërkesa: përbëheshin nga mendimi i një eksperti mjekësor në vend se të tre të kërkuar, dhe vlerësimi nuk ishte bërë në prani të gjyqtarit.

Veç kësaj, është e dukshme nga shqyrtimi i deklaratës së cituar më sipër se neuro-psikiatri shkoi shumë përtej kufijve të rolit të tij si ekspert mjekësor. Ky dëshmitar ekspert në një kohë ofroi dëshmitë që është dashur të vijnë nga punëtori social në rast, dhe në një tjetër kohë dukej se po mbronte paditësit duke i tërhequr vëmendjen gjykatës lidhur me argumentet e banorëve dhe pronarëve të dyqaneve dhe duke i përsëritur pohimet e tyre të pambështetura se, nëse nuk largohet, personi në fjalë do t’i “frikësojë fëmijët e tyre”. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e dukshme të personit që ishte objekt shqyrtimi në këtë procedurë, përpos rëndësisë së madhe të asaj me çfarë ballafaqohet – humbja e lirisë së tij – mangësitë në procedurën e provave të ekspertit në këtë rast janë veçanërisht alarmante.

4. PËRFUNDIM

Ky raport nënvizon tri fusha të procedurës së provave ku mangësitë e vërejtura ishin posaçërisht të theksuara. Fusha e parë përfshin procedurën e dëgjimit të dëshmitarëve, përfshirë këtu edhe rastet speciale të dëshmitarëve fëmijë dhe palëve që dëshmojnë në cilësi të dëshmitarëve. Fusha e dytë përfshinë nxjerrjen e shkresave si dëshmi, dhe e treta përfshin menaxhimin e procedurës së provave të ekspertëve. Shembujt e shqyrtuar të rasteve sugjerojnë se, përderisa korniza ligjore që rregullon procedurën civile të provave është- në pjesën më të madhe – në pajtueshmëri me standardet për gjykim të drejtë, zbatimi i tij nga gjykatat thënë më së miri ka qenë i pabarabartë. Në shumë raste, mangësitë e vërejtura në procedurën e provave apo procedurën e provave të ekspertëve, janë të atilla që nuk mund të thuhet se palët kanë pasur gjykim të drejtë.

Procedura e provave është një na gurë-themelet e procesit gjyqësor. Pa dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese në një rast, gjyqtari nuk do të jetë në gjendje të bëjë gjetjen e fakteve që duhet të mbështesin një aktgjykim të arsyetuar qartë dhe më kujdes. Ky është çelësi për të siguruar që të mos komprometohet e drejta për gjykim të drejtë. Në zemër të gjykimit të drejtë është e drejta për gjykim bazuar në parim të kundërshtimit. Kur një palë nuk ka as njohuri, e as të drejtë për të komentuar në provat e nxjerra nga pala kundërshtare, komprometohet e drejta për gjykim bazuar në parim të kundërshtimit. Kur dëgjimi i dëshmitarëve nuk mund të

⁷⁴ Shih fusnotën e sipërme 64.

kundërshtohet, dhe kur provat nuk nxjerrën në prani të palëve në një dëgjim publik me këndvështrim nga mundësia për argumentim kundërshtues, nuk mund të thuhet se palët kanë pasur gjykim të drejtë.

Gjykatat në Kosovë kanë për obligim pozitiv të mbrojnë integritetin e aktgjykimeve të tyre civile duke siguruar se aktgjykimet e tilla merren pas zbatimit të procedurës së ligjshme dhe të drejtë të provave. Për t'u përmbushur ky obligim kërkohet adoptimi i një qasje rigoroze dhe pro-aktive për menaxhimin e procedurës së provave në të gjitha rastet civile.

5. REKOMANDIME

Për gjykatat:

- Ta kenë të ditur dallimin ndërmjet pohimeve të bëra nga palët dhe dëshmimeve që ata kanë parashtruar në mbështetje të atyre pohimeve;
- Ta kenë të ditur nevojën për të dëgjuar dëshmitë prej të dy anëve në një rast;
- Në procedurat që ndikojnë në interesat e fëmijëve, t'i ofrojnë fëmijës mundësinë që të dëgjohet drejtpërdrejtë, përmes përfaqësuesit apo një organi të përshtatshëm;
- Në procedurat ku palët kërkojnë që të nxjerrën dëshmitë në formë të shkresave, ta kenë të ditur nevojën për të vlerësuar dhe për të vendosur lidhur me pranueshmërinë dhe/ose sa është relevante secila pjesë e dëshmisë në mënyrë individuale, përderisa ato administrohen gjatë rrjedhës së procedurës së provave;
- Atëherë kur të jetë e përshtatshme, të marrin parasysh shfrytëzimin e sanksioneve për të ndëshkuar dëshmitarët të cilët pa arsyetim dhe përkundër ftesës së rregullt, dështojnë të paraqiten pranë gjykatës ose dikë, që është paraqitur por refuzon të dëshmojë apo të përgjigjet në pyetje specifike;
- Atëherë kur të jetë e përshtatshme, të marrin parasysh shfrytëzimin e sanksioneve për të ndëshkuar dëshmitarët ekspertë të cilët dështojnë, pa arsyetim, të japin mendimet e tyre brenda afatit të caktuar nga gjykata ose ata të cilët, pasi t'i kenë dhënë mendimet e tyre dështojnë, pa arsyetim, të paraqiten pranë gjykatës; dhe
- Të shfrytëzojnë në tërësi procedurën paraprake për të menaxhuar më mirë procedurën e provave të ekspertit.

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:

- Të vazhdojë trajnimin e gjyqtarëve civil për procedurën e provave; në veçanti të merr parasysh ofrimin e trajnimeve në çështje që ndërlidhen me fëmijët si dëshmitarë, palët në raste civile që dëshmojnë në cilësi të dëshmitarëve,

nxjerrjen e provave në formë të shkresave dhe procedurën e provave të ekspertëve.